



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA TIRANË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E QEVERISJES ELEKTRONIKE DHE INOVACIONIT**  
**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. J-8968/ prot.

Tiranë, më 12.06 / 2024

Lënda: 2 Kthim përgjigje

**ZNJ. JONA PLUMBI**

**Rruga "Nasi Pavlo", godina "Edil-al", hyrja 1, kati 3, ap. 8,**  
**Njësia Administrative nr. 2, Tiranë**

E nderuar znj. Plumbi,

Pranë Bashkisë së Tiranës, bazuar në ligjin 119/2014 "Për të drejtën e Informimit" është paraqitur kërkesa juaj, e cila është protokolluar me nr. prot. J-8968, datë 28.05.2024 dhe ka kaluar për shqyrtim pranë Policisë Bashkiake, e cila ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. J-8968/1 prot., datë 06.06.2024 si vijon:

"Në përgjigje të shkresës së sipërcituar ju informojmë se, gjatë periudhës Janar–Maj 2024, pranë Policisë Bashkiake kanë ardhur rreth 110 ankesa në lidhje me ndotjen akustike, apo zhurmat shqetësuese, ankesa këto të ardhura në rrugë shkresore, me e-mail në adresën e Policisë Bashkiake, apo nga portalet e "Bashkëqeverisjes", "Tirana Ime", si dhe nëpërmjet sallës operative të Policisë Bashkiake. Këto ankesa vijnë kryesisht për ndotjen akustike apo zhurmat shqetësuese që shkaktohen gjatë procesit të ushtrimit të aktivitetit nga subjektet me veprimtari ekonomike Bar- Kafe, lavazhet e automjeteve, pompat e ujit në ambientet e përbashkëta të pallateve, banorë që kryejnë punime në banesat e tyre, duke mos respektuar normat detyruese të bashkëjetesës, furrat e bukës, kantieret e ndërtimit etj.

Në lidhje me ndotjen akustike të shkaktuar nga muzika e lartë që gjenerohet nga subjektet Bar-kafe, bazuar në Udhëzimin e përbashkët Nr. 2, date 15.11.2023, të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Ministrisë së Brendshme, Policia e Shtetit është institucioni që verifikon dhe merr masat, sipas kompetencave që i ngarkon udhëzimi i sipërcituar.

Policia Bashkiake nuk mund të përcaktojë nivelin e zhurmave, pasi ende nuk disponon aparatura, apo burime njerëzore të specializuara apo trajnuara, në verifikimin dhe kontrollin mbi nivelin kufi të zhurmës së lejuar nga personat fizikë e juridikë, që ushtrojnë veprimtari që gjenerojnë zhurma, në territorin e juridiksionit të tyre dhe për rrjedhojë nuk mund të përcaktojë vlerat kufi të zhurmës së lejuar.

Sa më sipër lutemi në dijeninë tuaj.

Me respekt

**KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

**Blerta Goxha**

